

Aksesi në drejtësi dhe barazia gjinore

Irena Majko

MA. Critical Gender Studies



Çfarë ju vjen në mendje kur dëgjoni
konceptin “pabarazi gjinore”?

- <https://www.menti.com/pa8hes6es7>

Çfarë është aksesimi në drejtësi?

- Është garancia kushtetuese që i mundëson individëve mbrojtjen e të drejtave të shkelura.
- Shtetet janë të detyruara të garantojnë të drejtën e çdo individit për t'ju drejtuar gjykatës ose organeve të tjera të administratës publike.
- Është element shumë i rëndësishëm i shtetit të së drejtës dhe rregullohet nëpërmjet akteve kryesore kombëtare (kushtetuta dhe ligjet) dhe aktet ndërkombëtare që janë të detyrueshme për t'u zbatuar.

Çfarë është aksesimi në drejtësi për gratë?

- Burrat dhe gratë kanë të drejtë në qajse të barabartë në sistemet e drejtësisë, nëpërmjet gjykatave dhe mekanizmave të tjerë të drejtësisë.
- Nevojat dhe përvojat e grave janë të ndryshme nga burrat për shkak të niveleve më të larta të varfërisë dhe dinamikës së fuqisë në familje dhe komunitet.
- Ka shumë pengesa për qasjen e grave në drejtësi ku përfshihet: **mungesa e diturisë rreth të drejtave ligjore, korupcionit, frika nga dëshmia, mungesa e burimeve, barrierat gjuhësore, mungesa e përfaqësimit në vendim-marrje.**

Pse duhet të fokusohemi tek askesi në drejtësi i grave?

- Diversiteti i karakteristikave personale dhe rrethanave në të cilat ndodhen gratë mund të çojnë në forma komplekse të përjashtimit, përkeqësimit e diskriminimit sistematik dhe strukturor, paragjytimeve dhe stereotipave.
- Gratë mund të përballen me sfida brenda fushave të kontekstit të martesës, familjes, punës, të drejtave të pronës; dhunës në familje, gjatë situatave në konflikt me ligjin, në emigracion, të drejtës së riprodhimit, mungesa e burimeve ekonomike, mungesa e njohurive ligjore etj.

Gratë dhe diskriminimi i shumfishtë

- Gratë që përballen me forma kryqëzuese të diskriminimit ka më shumë të ngjarë të përjashtohen nga institucionet e drejtësisë duke mos marrë shërbimin e duhur dhe duke u ndier të marginalizuara dhe diskriminuara.
- Gratë nuk janë një grup homogjen. Disa karakteristika personale dhe rrethanat e situatës shpesh kombinohen për të thelluar përjashtimin dhe marginalizimin e tyre.

Karakteristika personale

Mosha, atësitë e veçanta/kufizuara, përkatësia etnike/racore, gjuha, arsimimi, nacionaliteti, feja dhe besimet, statusi martesor, drejtimi politik, orientimi seksual, identiteti gjinor etj.

Rrethanat në të cilat gratë mund të ndodhen

Statusi ekonomik, statusi social, vendbanimi zonë urbane/zonë ruale, analfabetizmi, rolet gjinore (gratë si kujdestare të familjes, fëmijëve, gratë në kushte që u mohohen të drejtat, gra në rrethana konflikti, migracioni, gra të pastreha etj.

Korniza ligjore për aksesin në drejtësi për gratë

Kushtetuta

Konventat e ratifikuara

Ligjet
e kuvendit

Mekanizmat zbatues

- Shtetet kanë për detyrë të respektojnë, mbrojnë dhe përmbushin të drejtat e njeriut.
- Shteti të parandalojë dhunën dhe shkelje të tjera të të drejtave të njeriut brenda territorit të tij.
- Në nivel kombëtar krijohen institucione kombëtare për promovimin dhe mbrojtjen e të drejtave të njeriut, si Avokati i Popullit apo komisionet kombëtare për të drejtat e njeriut

- Komisioni për mbrojtjen nga diskriminimi;
- Komisioni për të drejtat e njeriut;
- Nënkomisioni për barazinë gjinore dhe parandalimin e dhunës ndaj gruas;

Si mund të përmirësohet aksesimi në drejtësi për gratë?

- <https://padlet.com/irenamajko268/meabt9u26ruvlby2>

Masa për përmirësimin e aksesit në drejtësi të grave

- **Ndihma juridike falas**, në mënyrë që këshillimi ligjor dhe gjykatat të bëhen më të aksesueshme.
- **Lehtësim i burokracive** për të përmirësuar aksesin në drejtësi për grupet e pafavorizuara.
- **Përmirësohen njohuritë** mbi të drejtat dhe liritë si dhe të kornizave ligjore
- **Bashkëpunim** midis aktorëve e sektorit të drejtësisë: institucione dhe shoqërisë civile.

Falemiderit!